

STATUTI

I

Yuniko Afmitech Services" ("Y.A.S.")

"Y.A.S LLC Albania" shpk

Ne kete statut -

"Ligji"eshte Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite tre gtare"; -
"Statuti" eshte Statuti i shoqerise;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja, Selia

Neni 1:

Sot, me12/10/2020, ne themeluesit, kami krijuar nje shoqeri me pergjegjeesi te kufizuar me emerin **"Y.A.S LLC Albania" shpk**

Themelues te shoqerise jane:

1. **z.Willem van Starckenburg ,Nr. ID NV814H260,Hollande.**
2. **z. Jan Boele de Jong , Nr. ID NNHD72085, Hollande**

Neni 2:

Objekti

Shoqeria do te kryeje aktivitetin e meposhtem: **Sherbime te ndryshme mjedisore.**

- Zhvillimi i projekteve të ndërtimit
- Ndërtimi i projekteve të shërbimeve komunale
- Ndërtimi i projekteve të ujit
- Aktivitete përkatëse inxhinierike dhe konsulencë teknike
- Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme
- Trajtimi dhe asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme
- Aktivitete të rehabilitimit dhe shërbime të tjera të menaxhimit të mbetjeve etj.

veprimtari qe do te kryhet ne baze te legjislacionit shqiptar.

Moz 26/10/20

JB
22/10/20

Neni 3:

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqerise do te jete 5 vjecare.

Neni 4:

Selia

Selia e shoqerise tregtare private "Y.A.S LLC Albania" sh.p.k do te kete seline ne Tirane, Helmes ,Shtodher, rruga Princ Topia, object 1 katesh, me zone kadastrale nr.3427, nr.pasurie 125/10.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojte filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakeve.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali I Shoqerise

Kapitali fillestar I shoqerise private "Y.A.S LLC Albania" sh.p.k do te jete 100,000 leke si me poshte:

- **Willem van Starckenburg** 50,000 leke
- **Jan Boele de Jong** 50,000 leke

Kapitali themeltar fillestar mund te shtohet ose te pakesohet (por jo nen vleren e kapitalit themeltar fillestar).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve te pjeseve per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre. Ne asnje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin ne kapitalin themeltar te shoqerise. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim qe kerkohet per ndryshimin e statutit.

WS 26/10 20


27/10/20

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) Kontributit ne kapitalin e shoqerise
- b) Shitblerjes
- c) Trashegimise
- d) Dhurimit
- e) Cdo menyre tjeter e fituar me ligj.

Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga casti i kalimit te kuotave deri ne castin e regjistrimit te kalimit te saje ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43, te ligjit nr.9723, date 03.05.2007, "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

ORGANI VENDIMMARRES

Asambleja e ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos per ceshtje si :

- a) Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve
- c) Emerimin dhe shkarkimin e likujdvesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar

WS
26.10.20

B 22/10/20

d) percaktimin e shperblimeve

e) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,

f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.

Te gjitha vendimet e marra nga **asambleja e ortakeve**, regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar ne vecanti por pa u kufizuar ne to, vendimet per :

a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise

b) shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve

c) investime

d) vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund ti kunderdrejtoje pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.

Neni 9:

Menyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te permabje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikese 1 te ketij neni , ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem nese Ortaku eshte dakord, per te marre vendime, pavarsisht parregullise.

Neni 10

Kuorumi

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefshme vetem nese merr pjese Ortaku me te drejte vote, qe zoteron me shume se 30 per qind te kuotave. Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat cerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund te marre vendime te vlefshme vetem, nese Ortaku eshte i pranishem personalisht, voton me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji. Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per

WS
26.10.20

B
22/10/20

shkak te mungeses se kuorunit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te kejtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e pergjithshme vendos me tre te katertat e votave te zoterueseve te Kapitalit, te ortakeve pjesemarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise. Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a)Percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
 - b)Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
 - c)Emerimin e shkarkimin i lukuidueseve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - g) Percaktimin e shperblimeve;
 - d)Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetoredhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e)Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e e tjera ndaj administratoreve;
- Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese; Cdo ndryshim satuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 12:

Perjashtimi nga e drejta e votes

1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr ne analize:

- a)Vleresimin e veprimtarise se tij;
- b)Shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
- c)Ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
- 9) Dhenien ose jo te perfitimeve te reja.

2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari ka te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

WS
26.10.20


22/10/20

Neni 13

Administrimi

Administratori i shoqërisë "Y.A.S LLC Albania" sh.p.k, do të jetë z. Ruzhdi Islamaj, i datë lindjes 09/06/1966, me nr.ID G60609136M, emëruar në këtë detyrë për një afat të perkohshëm deri më 31/12/2020, me të drejtë ripërteritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

Neni 14

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të :

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme ,
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare,
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentave dhe të librave kontabel të shoqërisë,
- ç) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim,
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kercenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe egzistencën e shoqërisë,
- dh) kryejë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendren Kombëtare të Regjistrimit.
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vecante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë në rastet kur:

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose egzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda dy viteve të para të regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridik, publikë ose privatë vendas apo të huaj, autoritetëve shtetërorë apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretet në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretet nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

WS
26.10.20


26/10/20

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke patur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Neni 15:

Pergjegjesite e Administratorit

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te trteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise. Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marreveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese. Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) Te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimi te veprimtarise se shoqerise ne mjedis;

b) Te ushtroje kompetenca qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te percaktuara ne keto dispozita;

c) Te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;

ç) Te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, present apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;

d) Te ushtroje detyrat e tij me profesionalizimin dhe kujdesin e nevojshem

2. Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, pergjigjet ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellimet e shoqerise, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.

3. Nese administratori vepron ne kundersiztim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij neni, eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata pergjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidarare.

4. Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundersiztim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e meposhtme:

a) U kthen ortakeve kontributet;

b) U paguan ortakeve interesa apo dividend;

c) U shperndan aktivet shoqerise;

WS
26.10.20

B
22/10/20

c) Lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregatare, kur, ne baze te gjendjes financiare, duhej te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet;

d) Jep kredi. Perverc padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, Ortaku individualisht, ka te drejte te ngreje padi penale kunder administratorit. Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plote te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 16:

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17:

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjitha dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomike tregtare te shoqerise, ate gjithevjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve. Ne perfundim te kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

Kreu V

Prishja — riorganizimi i shoqerise

Neni 18:

Prishja dhe likujdimi

Shoqeria ose prishja e shoqerise mund te behet ne cdo kohe:

- a) Kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) Me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c) Me hapjen e procedurave te fahmentimit,

WS
26.10.20

B
22/10/20

g) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";

d) Me vendim te gjykates; Ne kete rast Ortaku merr vendim me shkrim ne te cilin parashikojne likuidimin e shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo docum emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese "Shoqeri ne likuidim e siper". Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit pagueese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit te emeruar nga Ortaku. Nese Ortaku nuk merr nje vendim per emerimin e likuidueseve, brenda 30 diteve cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

Neni 19:

Riorganizimi i shoqerise bashkimi-ndarja

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendimit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjit 9901 date 14.04.2012 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specific ne republiken e Shqiperise.

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit " Per Shoqerite Tregtare", Kodi Civil dhe cfaredo ligji tjeter specific ne republiken e Shqiperise. Per mosmarrveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e statutit te Shoqerise, ortaket i drejtohen per kompetence Gjykatave Shqiptare.


Neni 21

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 kopjo(ekzemplare) me permbajtje dhe vlera te njejta juridike. Akti i mesiperme pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shoqerise tregtare "Y.A.S LLC Albania " shpk, nenshkruset ne te gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale.

ORTAKET THEMELUES:

Willem van Starckenburg



26.10.20

Jan Boele de Jong



22/10/2020